На основу чланова 12. и 17. Закона о локалној самоуправи бр. 03/L-040 („Службени лист РК“ бр. 28/2008), члана 9. и члана 19. став 1. Статута општине Звечан, као и на основу Закона бр. 02/L-26 о пољопривредном земљишту, а на препоруку Одбора за политику и финансије, након претходног разматрања и гласања, на својој 7. (седмој) редовној седници у 2026. години, одржаној дана 12.08.2026. године, доноси:

О Д Л У К У

о покретању поступка промене намене пољопривредног земљишта у грађевинско земљиште за катастарску парцелу број 113-0, КО Звечан

Члан 1.

Покреће се поступак промене намене пољопривредног земљишта у грађевинско земљиште за катастарску парцелу број 113-0, КО Звечан;

Члан 2.

Поступак из члана 1. ове одлуке покреће се у складу са чланом 44. став 1. Закона бр. 02/L-26 о пољопривредном земљишту, имајући у виду да општина Звечан нема усвојен Просторни план којим би предметно земљиште било одређено за непољопривредну, односно грађевинску намену.

Овом одлуком ствара се правни основ за предузимање даљих радњи ради утврђивања испуњености законом прописаних услова за промену намене предметног земљишта.

Члан 3.

Задужују се надлежне општинске дирекције да, у оквиру својих надлежности, предузму све потребне административне, стручне и друге радње ради спровођења поступка промене намене земљишта из члана 1. ове одлуке.

У поступку из претходног става прибавиће се потребна катастарска и друга документација, утврдити релевантни подаци о предметним катастарским парцелама и прибавити потребна мишљења, сагласности и други акти надлежних органа, уколико су прописани важећим законодавством.

Члан 4.

Промена намене предметног земљишта може се спровести након утврђивања испуњености свих законом прописаних услова и окончања одговарајућих поступака пред надлежним органима.

По окончању поступка, надлежни органи предузеће потребне радње ради евидентирања насталих промена у одговарајућим службеним и катастарским евиденцијама, у складу са законом.

Члан 5.

За спровођење ове одлуке задужује се Дирекција за урбанизам, планирање и заштиту животне средине општине Звечан, у оквиру својих законом и Статутом утврђених надлежности.

Члан 6.

Ова одлука ступа на снагу 30 дана од дана достављања надзорном органу, у смислу члана 8, у вези са чланом 9 Закона бр. 08/L-284 о управном преиспитивању општинских аката, и 7 дана од јавног објављивања на огласној табли или званичној веб страници општине.

О Б Р А З Л О Ж Е Њ Е

Директорат за урбанизам, планирање и заштиту животне средине општине Звечан обратио се Скупштини општине Звечан захтевом у вези са променом намене пољопривредног земљишта у грађевинско земљиште за катастарску парцелу број 113-0, КО Звечан, ради покретања поступка и предузимања даљих радњи у складу са важећим законским прописима.

Правни основ за поступање Скупштине општине садржан је у члану 44. став 1. Закона бр. 02/L-26 о пољопривредном земљишту, којим је предвиђена могућност пренамене пољопривредног земљишта у непољопривредне сврхе на основу одлуке Скупштине општине у случају када општина нема усвојен Просторни план.

Имајући у виду да општина Звечан нема усвојен Просторни план којим би предметне катастарске парцеле биле одређене за непољопривредну, односно грађевинску намену, као и захтев надлежног Директората, оцењено је да постоји основ да Скупштина општине Звечан донесе одлуку о покретању поступка промене намене предметног земљишта.

Доношењем ове одлуке ствара се правни основ за предузимање потребних административних, стручних и других радњи, прибављање прописане документације, мишљења и сагласности надлежних органа, као и утврђивање испуњености свих

Имајући у виду наведено, Скупштина општине Звечан донела је Одлуку о покретању поступка промене намене пољопривредног земљишта у грађевинско земљиште за катастарску парцелу број 113-0, КО Звечан, као у диспозитиву.

Председавајући Скупштине
општине Звечан

Др Срђан Милосављевић

Në bazë të neneve 12 dhe 17 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale („Gazeta Zyrtare e RK-së“ nr. 28/2008), nenit 9 dhe nenit 19 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Zveçanit, si dhe në bazë të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, në mbledhjen e saj të 7-të (shtatë) të rregullt në vitin 2026, të mbajtur më 12.08.2026, nxjerr:

V E N D I M

për inicimin e procedurës së ndryshimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për parcelën kadastrale nr. 113-0, ZK Zveçan

Neni 1.

Inicohet procedura e ndryshimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për parcelën kadastrale nr. 113-0, ZK Zveçan;

Neni 2.

Procedura nga neni 1 i këtij vendimi iniciohet në pajtim me nenin 44 paragrafi 1 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, duke pasur parasysh se Komuna e Zveçanit nuk ka Plan Hapësinor të miratuar, me të cilin toka në fjalë do të ishte përcaktuar për destinim jobujqësor, përkatësisht ndërtimor.

Me këtë vendim krijohet baza juridike për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme me qëllim të konstatimit të përmbushjes së kushteve të përcaktuara me ligj për ndryshimin e destinimit të tokës në fjalë.

Neni 3.

Obligohen drejtoritë kompetente komunale që, në kuadër të kompetencave të tyre, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative, profesionale dhe veprimet e tjera për zbatimin e procedurës së ndryshimit të destinimit të tokës nga neni 1 i këtij vendimi.

Në procedurën nga paragrafi paraprak do të sigurohet dokumentacioni i nevojshëm kadastral dhe dokumentacioni tjetër, do të vërtetohen të dhënat relevante për parcelën kadastrale në fjalë dhe do të sigurohen mendimet, pëlqimet dhe aktet e tjera të nevojshme të organeve kompetente, nëse ato parashihen me legjislacionin në fuqi.

Neni 4.

Ndryshimi i destinimit të tokës në fjalë mund të zbatohet pas konstatimit të përmbushjes së të gjitha kushteve të përcaktuara me ligj dhe përfundimit të procedurave përkatëse pranë organeve kompetente.

Pas përfundimit të procedurës, organet kompetente do të ndërmarrin veprimet e nevojshme për evidentimin e ndryshimeve të krijuara në evidencat përkatëse zyrtare dhe kadastrale, në pajtim me ligjin.

Neni 5.

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Zveçanit, në kuadër të kompetencave të saj të përcaktuara me ligj dhe me Statut.

Neni 6.

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë nga dita e dorëzimit organit mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, në lidhje me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe 7 ditë pas publikimit në tabelën e shpalljeve ose në ueb-faqen zyrtare të komunës.

A R S Y E T I M

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Zveçanit i është drejtuar Kuvendit të Komunës së Zveçanit me kërkesë lidhur me ndryshimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për parcelën kadastrale nr. 113-0, ZK Zveçan, me qëllim të inicimit të procedurës dhe ndërmarrjes së veprimeve të mëtejshme në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Baza juridike për veprimin e Kuvendit të Komunës përmbahet në nenin 44 paragrafi 1 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, me të cilin parashihet mundësia e ndryshimit të destinimit të tokës bujqësore për qëllime jobujqësore në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës, në rastin kur komuna nuk ka Plan Hapësinor të miratuar.

Duke pasur parasysh se Komuna e Zveçanit nuk ka Plan Hapësinor të miratuar me të cilin parcela kadastrale në fjalë do të ishte përcaktuar për destinim jobujqësor, përkatësisht ndërtimor, si dhe kërkesën e Drejtorisë kompetente, është vlerësuar se ekziston baza që Kuvendi i Komunës së Zveçanit të nxjerrë vendim për inicimin e procedurës së ndryshimit të destinimit të tokës në fjalë.

Me nxjerrjen e këtij vendimi krijohet baza juridike për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme administrative, profesionale dhe veprimeve të tjera, sigurimin e dokumentacionit të përcaktuar, mendimeve dhe pëlqimeve të organeve kompetente, si dhe konstatimin e

përmbushjes së të gjitha kushteve të përcaktuara me ligj për ndryshimin e destinimit të tokës në fjalë.

Duke pasur parasysh sa më sipër, Kuvendi i Komunës së Zveçanit nxori Vendimin për inicimin e procedurës së ndryshimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për parcelën kadastrale nr. 113-0, ZK Zveçan, si në dispozitiv.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Zveçanit

Dr. Srđan Milosavljević